

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Se për ta, liria e Kosovës ishte e para - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/se-per-ta-liria-e-kosoves-ishte-e-para
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 05:38:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 05:32:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7f2ea49b4445d851af6d8e27d37ff8427f269526d56b94a6290eaa190b5c4f33
TEKSTI	4d0eefc53817252553bb6671942ec0b124ed755ed8236856d6314f6373e413dd
PAMJA	3152ce7708dec3fdb19f3174cf67f44451d933e773f330bc54cd795061c04e98

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5945342d0f937e1c5bbe8315e5ea1c8cf45b72b49cb10034218477b5d6444ad4
E MËPARSHMJA	52869a160af356c82dc1232d9774d67a977f50683bbaad1a4a13e0be6a069b68
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5945342d0f937e1c5bbe8315e5ea1c8cf45b72b49cb10034218477b5d6444ad4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



E përplasi makina në aksin Elbasan-Peqin, humb jetën këmbësorja

<>

Opinion

Se për ta, liria e Kosovës ishte e para

Hashim Thaçi e kishte treguar veten, edhe pse i ri në moshë, i kthjellët dhe me vizion të dukshëm, koshient për çka luftonte së toku me popullin e tij dhe për të qënë përballë asaj Gjykate që e ngritën vetë.



Hashim Thaçi



Leonidha Mertiri

19 Shtator, 07:31 | Përditësimi: 19 Shtator, 07:32

f Share Tweet



A A

Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç, një javë më parë pohonte për Danas-in se, gjatë vizitës së atyre ditëve në Paris, kishte dëgjuar se Hashim Thaçi mund të dënohej rëndë nga Gjykata Speciale në Hagë. E çuditshme, por dy javë më parë, si ta kishte harruar jo më kot, me një siguri marramendëse, provokim apo për të krijuar përshtjellim te shqiptarët, e shihte lirinë e Thaçit nga paraburgimi me një dënim që i përgjigjej kohës së këtij paraburgimi.

Ish Ministri i Informacionit në qeverinë e Sllobodan Milosheviçit gjatë periudhës 1998-2000, presidenti aktual, është i njohur si mbështetës i kasaphanave të serbeve. Ambasadori i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë(OSBE), në ato vite në Prishtinë, pohon se "çfarë Vuçiç bën me informacione, dezinformata, kuptohet në të gjitha kryeqytetet e Europës...Ai ishte në zinxhirin komandues të Qeverisë së Milosheviçit".

E vërteta është se trupat serbe ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë kanë kryer masakra të papara. Është po ky Vuçiç, sot President i Serbisë dhe nesër pret të zëjë karriken e kryeministrit, shprehu gjithë interesimin, që, duke glorifikuar kriminelë të njohur të luftës si Ratko Mlladiç, ish i dënuar në Hagë për genocid dhe krime të tjera të panumërta, të jetë i përkushtuar që shteti serb t'ia bënte varrimin, sikurse pohonte kreu i shtetit, "në mënyrë dinjitoze". Tani, Aksandar Vuçiç ndjehet i lumtur. Gjykata e Hagës iu përgjigj atij dhe mbështetësve ëndërrues me dënimin e katër udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ia bën më të sigurt fitoren në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe atë të karriges së kryeministrit.

[Sh]
.com



LEXO EDHE:
Vendimi për ish-krerët e UÇK, studentët marshojnë sot në Prishtinë! Thirrje partive politike për unitet

Po si u krijua kjo Gjykatë Speciale? Në mbështetje të saj ishin jo pak njerëz. Ndërkohë, presioni mbi

Kosovën nuk ishte i vogël. Kërkohej mahana për trahana, që Kosovës t'i sfumohej pavarësia, e fituar me sakrificë të mëdha, duke shpresuar që ajo të kthehej në duart e serbëve. Ëndrra në diell të këtyre të fundit. Miratimi në parlamentin e Kosovës i ngritjes së kësaj Gjykate nuk ishte i lehtë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera të Perëndimit ishin më këmbëngulësit që i kërkonin Kuvendit të Kosovës krijimin e Gjykatës Speciale. Legjenda e "Shtëpisë së Verdhë" për heqjen e organeve të serbëve të vrarë apo të zënë robër reklamohej me të madhe nga komisionieri zvicerian, Dick Marty, i njohur për qëndrimet e mbajtura ndaj pavarësisë së Kosovës, duke i ardhur në ndihmë propagandës serbe dhe qarqeve të ndryshme ndërkombëtare.

Shtetet anëtare të QUINT-it, SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia, përmes një letre u kërkonin autoriteteve kosovare ta miratojnë atë në parlament. Një deklaratë e ambasadorit të Mbretërisë së Bashkuar në Serbi, Cliff, theksonte se, po të mos formohej kjo Gjykatë me staf ndërkombëtar, Rusia do t'i drejtohej Këshillit të Sigurimit, gjë që nuk do të ishte aspak në interes të Kosovës. Kurse drejtorja e Human Right Watch në Bashkimin Evropian e shihte parlamentin si të tillë, që duhet të sjellë drejtësi për abuzimet serioze.

Këto dhe kontaktet e tjera me ndërkombëtarët për ngritjen e Gjykatës, edhe pse jo e lehtë, nuk e lëkundën Hashim Thaçin dhe as luftëtarët e shquar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndryshe, do gjendej një formë tjetër për ta ngritur atë. Miratimi i saj mund t'i kalonte Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Por udhëheqësit e denjë të UÇK-së, me ndërgjegje të plotë e morën përsipër vetë. Ishin larg çdo sajese të Dick Martyt dhe disa të shiturve, që në çdo kohë të vrasin në heshtje dhe pastaj të qajnë me kuje, duke goditur dhe mohuar luftën e paqme të UÇK-së. Pasojat e shpifjeve të këtyre të fundit do të bëheshin, sikurse edhe ndodhi, dëshmi të jetësimit të vendimit të pardjeshëm të Gjykatës Speciale. Dosjet serbe ishin ushqimi i parë i këtij verdikti.

Hashim Thaçi e kishte treguar veten, edhe pse i ri në moshë, i kthjellët dhe me vizion të dukshëm, koshtient për çka luftonte së toku me popullin e tij dhe për të qënë përballë asaj Gjykate që e ngritën vetë. Se për të dhe komandantët, luftëtarët e UÇK-së, liria, pavarësia e Kosovës ishin të parat, më të shtrenjtat. Larg, shumë larg shtetit serb, genocidi i të cilit ishte shumë i organizuar përballë një populli të vuajtur dhe të pambrojtur nga regjimi serb dhe të një UÇK-je, me djem dhe vajza shqiptare, të vendosur në rrugën për lirinë e Kosovës dhe popullit të saj.

81 vite burg për çlirimtarët e Kosovës. E papritur. Një komb i tërë i shqetësuar me të drejtë. Por jo, jo i pashpresë. Larg euforisë, por dhe çdo lëkundjeje që nuk është në favor të çeshtjes sonë Provat kundërshtohen me një trup solid, të bashkuar Shqipëri-Kosovë, përmes një mori faktesh të njohura për botën, me juristë të shquar me mjekër, ndërkombëtarë dhe vendas.

Puna e diplomacisë shqiptare për të vërtetat e Kosovës, për çlirimin dhe pavarësinë e saj është tashmë një përvojë e dukshme. Ajo duhet t'i shërbejë klasës politike në Tiranë dhe Prishtinë, kudo që punojnë dhe jetojnë shqiptarët, t'i përgjigjet Gjykatës Speciale të Hagës, opinionit botëror në tërësi me kujtesën tonë, me një lobim të fuqishëm.

S.I.E./Shqiptarja.com

TAG: [hashim thaci](#) [Gjyqi ndaj UCK ne Hage](#) [Leonidha Mertiri](#) [aleksander vucic](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ 5.0 / 5 (2 vlerësime)

OPINIONET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës: Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë Të gabuar Nuk e di

Lajme të tjera



Preç Zogaj: Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë



Preç Zogaj



Protestuesit 5 net në shesh kundër vendimit të Hagës, 'skuqet' Prishtina! Shpaloset flamuri Kombëtar gjigant, kërkohet drejtësi për 4 ish-krerët e UÇK (VIDEO)



Dënimi me 81 vite burg i 4 ish-krerëve të UÇK, shqiptarët protestë edhe në Vjenë të Austrisë: O Hashim, ti ku je, krejt Kosovën këtu e ke! (VIDEO)



21 Shtator, 00:34



Njeriu i 17 shkurtit nën hijen e 16 shtatorit

20 Shtator, 15:11

20 Shtator, 21:28



Verdikti i Hagës ndaj krerëve të UÇK-së, Tedi Blushi kërkon interperlancë me Ramën: Çfarë hapash do ndërmarrë Qeveria për rrëzimin e aktgjykimit?

20 Shtator, 13:40

20 Shtator, 16:25



Vuçiç akuzon Perëndimin për standarde të dyfishta: Për Mlladiçin na sulmuan, për Thaçin heshtën

20 Shtator, 10:50



A ishte paralajmëruar dënimi i ish-krerëve të UÇK-së? Kryeprokurori i Speciales më 2020: Do burgosen përjetë

20 Shtator, 08:54



5 ditë pas vendimit të Hagës, Prishtina sërish në shesh: Na ka bashkuar UÇK-ja! Tubime edhe në Gjermani, Zvicër, Austri e Kanada (VIDEO)

20 Shtator, 07:15



Vendimi ndaj ish krerëve të UÇK-së, Kurti nga SHBA: Duhet strategji shtetërore dhe bashkëpunim me aleatët tanë ndërkombëtarë

19 Shtator, 22:52



Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

19 Shtator, 21:58



Dënimi i liderëve të UÇK, Prishtina sërish në protestë! Tubime në Gjermani e Austri

19 Shtator, 21:43



Pandeli Majko: Ku gabuam...?



Pandeli Majko

19 Shtator, 19:22

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.